

THE AIRE CENTRE
Advice on Individual Rights in Europe



CIVIL RIGHTS DEFENDERS



Forumi i Shtatë Vjetor Rajonal i
SHTETIT TË SË DREJTËS
në Evropën Juglindore



Kingdom of the Netherlands



Covid-19 dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut

16-17 tetor 2020

1. Hyrje

Çfarë është Forumi i Evropës Juglindore për Sundimin e Ligjit?

Forumi, i themeluar nga Qendra AIRE (AIRE Center) dhe Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut (Human Rights Defenders), ofron një platformë për të promovuar jetësimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) në tërë Evropën Juglindore. Ai bashkon gjyqtarë të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) nga vendet e rajonit me gjyqtarë dhe kryetarë të gjykatave supreme dhe kushtetuese nga vendet e rajonit, kryetarë të këshillave gjyqësore, drejtorë të instituteve për trajnime gjyqësore, agjentë të qeverive para Gjykatës së Strasburgut, përfaqësues të OJQ-ve dhe ekspertë të shquar ligjorë të fushës. Organizatorët dhe pjesëmarrësit e Forumit punojnë për të nxitur bashkëpunimin rajonal për fuqizimin e sundimit të ligjit dhe respektit për të drejtat e njeriut, dhe për t'u ofruar ndihmë vendeve të Evropës Juglindore në procesin e integritimit në BE.

Forumi është rezultat i partneritetit të gjatë mes Programit të Qendrës AIRE për Ballkanin Perëndimor dhe Mbrojtësve të të Drejtave të Njeriut, organizata të cilat kanë përvojë të thellë në punën drejt fuqizimit të sundimit të ligjit në rajon. Njëkohësisht, Forumi i detyrohet bashkëpunimit të vazhdueshëm jetik me Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, pa të cilën puna jonë do të ishte pa dyshim e pamjaftueshme. Në fund, duhet të falënderojmë përkrahësit e Forumit dhe përkushtimin e tyre të vazhduar ndaj parimeve të sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut: Qeverinë e Mbretërisë

së Bashkuar, Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar, Fondacionin Konrad Adenauer, dhe Qeverinë e Holandës.

Forumi 2020: Covid-19 dhe Impakti mbi të Drejtat e Njeriut

Në vitin 2020, Forumi i Shtatë Vjetor i Sundimit të Ligjit ishte forumi më i rëndësishëm që kemi mbajtur ndonjëherë. Megjithatë kufizimet e pandemisë së Covid-19 e bënë të pamundur mbajtjen e një konference të madhe në Evropën Juglindore, u realizua një format hibrid për të ftuar pjesëmarrjen dhe debatet nga i tërë kontinenti në një platformë të përbashkët.

Me qendër në rajonin e Strasburgut, ku u zhvilluan diskutimet kryesore të Forumit, u realizuan lidhje virtuale gjatë Forumit me shtatë qytete ku ndodhen qendrat ligjore të rajonit. Përfaqësues nga të gjitha komunitetet ligjore të Evropës Juglindore u mbledhën në grupe prej 30 vetash në Beograd, Podgoricë, Prishtinë, Sarajevë, Shkup, Tiranë dhe Zagreb për t'iu bashkuar Forumit online duke e shfrytëzuar si mundësi për takime dhe debate, si dhe për të kontribuar me mësimet e nxjerra nga përvojat nacionale në vendet e tyre përkatëse me qëllim të ngritjes së të kuptuarit mes vendeve të rajonit dhe zhvillimit të praktikave më të mira. Forumi përfitoi mjaft nga kombinimi i njohurive dhe përvojave të mbi 200 pjesëmarrësve nga tetë qendra të ndryshme. Këtyre delegatëve iu bashkuan rreth 300 pjesëmarrës online, të cilët patën mundësinë të përfshiheshin në sesionet e pyetje-përgjigjeve përgjatë tërë procesit.

Kufizimet e vendosura në tërë Evropën në reagim ndaj pandemisë së Covid-19 jo vetëm që penguan që Forumi të zhvillohej në formën e zakonshme, po njëkohësisht penguan mbajtjen fizike të thuajse të gjitha takimeve dhe diskutimeve të zakonshme që zhvillohen çdo vit në tërë kontinentin.

Prandaj, për shumicën e pjesëmarrësve Forumi 2020 ishte e vetmja mundësi këtë vit për t'u bashkuar, personalisht, për të diskutuar rreth çështjeve më të rëndësishme të vitit dhe mbase rreth sfidës më madhore me të cilën përballen sundimi i ligjit dhe rendi ligjor i bazuar mbi të drejtat e njeriut qysh prej vitit 1945. Natyra panevropiane e Forumit 2020, me pjesëmarrës jo vetëm nga Evropa Juglindore por edhe nga tërë kontinenti, dëshmoi një fakt që ka qenë i vërtetë gjithmonë, që megjithëse ky është Forum i Evropës Juglindore, puna e bërë dhe çështjet e ngritura dhe të debatuar këtu janë po aq relevante dhe të rëndësishme për të gjitha hapësirat e kontinentit tonë të përbashkët.

Ndërkohë që Forumi 2020 origjinal duhet të mbahej në pranverë, mbyllja fillestare e të gjitha qyteteve evropiane e bëri një ngjarje të tillë të pamundur. Andaj, ky Forum u krijua për një qëllim të vetëm, që të adresonte me shpejtësi dhe në tërësi çështjen më domethënëse me të cilën përballen sundimi i ligjit dhe sistemi i Konventës në Evropë. Për këtë qëllim, që e rëndësishme që të përfshihej jo vetëm komuniteti ligjor i Evropës Juglindore, por edhe të sillleshin këndvështrime përtej komunitetit më të gjerë ligjor evropian.



Folësit dhe Panelistët e Forumit

Forumit përfitoi nga prania e shumë ekspertëve të lartë gjyqësorë nga Evropa dhe rajoni. Në emër të Këshillit të Evropës dhe GjEDNJ-së, diskutimet qendrore u drejtuan nga:



Robert Spano

President i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut



Dunja Mijatović

Komisionere e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut



Paul Lemmens

Gjyqtar i GjEDNJ-së i zgjedhur në emër të Belgjikës



Faris Vehabović

Gjyqtar i GjEDNJ-së i zgjedhur në emër të Bosnje dhe Hercegovinës



Tim Eicke

Gjyqtar i GjEDNJ-së i zgjedhur në emër të Mbretërisë së Bashkuar



Jovan Ilievski

Gjyqtar i GjEDNJ-së i zgjedhur në emër të Maqedonisë së Veriut



Ivana Jelić

Gjyqtare e GjEDNJ-së e zgjedhur në emër të Malit të Zi



Darian Pavli

Gjyqtar i GjEDNJ-së i zgjedhur në emër të Shqipërisë



Anja Seibert-Fohr

Gjyqtare e GjEDNJ-së e zgjedhur në emër të Gjermanisë



Ledi Bianku

Ish-gjyqtar i GjEDNJ-së



Mirjana Lazarova Trajkovska

Ish-gjyqtare e GjEDNJ-së



Krešimir Kamber

Jurist pranë Drejtorisë së Juriskonsultit në Sekretariatit e GjEDNJ-së

Në qendrat rajonale nëpër qytete, Forumi po ashtu përfitoi nga prania e kryetarëve dhe gjyqtarëve të gjykatave supreme dhe kushtetuese të rajonit, ministrave të drejtësisë, ambasadorëve dhe përfaqësuesve nga vendet mbështetëse, ombudspersonave, përfaqësuesve nacionalë pranë GjEDNJ-së dhe figurave të shquara nga bota akademike. Ekspertiza dhe cilësia e kontributeve të tyre në diskutimet e Forumit ishin të rëndësishme themelore për të siguruar që Forumi i këtij viti ta ruante shtrirjen e vet në Evropën Juglindore dhe të vazhdonte të mbetej relevant për problemet dhe sfidat e rajonit.

Udhërrëfyeni i Forumit 2020

Forumi i këtij viti gjithashtu u shoqërua nga ai që është mbase publikimi më ambicioz deri tani, një udhërrëfyes praktik për profesionistët gjyqësorë dhe ligjorë rreth mënyrave për trajtimin e çështjeve të prekura nga impakti i pandemisë së Covid-19 dhe reagimeve të Shtetit ndaj pandemisë. Udhërrëfyeni përfshin analiza të detyrimeve pozitive që Shtetet mund të pritët, brenda arsyes, të përbushin për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e njerëzve nga kërcënimi i Covid-19, dhe shembuj të disa prej mënyrave se si janë prekur të drejtat e Konventës nga masat e marra prej Shteteve për të mbrojtur shëndetin e qytetarëve të tyre.



Shpresojmë që udhërrëfyeni do të ndihmojë ushtruesit e profesionit gjyqësor dhe ligjor, si dhe vendimmarrësit e ndryshëm, për të vlerësuar se si Shtetet duhet të strukturojnë reagimet e tyre ndaj pandemisë në mënyrë që të mbrohet shëndeti pa komprometuar qëllimin tonë të përbashkët të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Përtej gjykatave dhe qeverisë, gjithashtu shpresojmë që ky udhërrëfyes të ndihmojë edhe organizatat joqeveritare që punojnë me individë të drejtat dhe liritë e të cilëve janë prekur gjatë pandemisë. Më tej, shpresojmë që ky udhërrëfyes t'i vijë në ndihmë kujtdo që ka interes ta lexojë.

Ndërkohë që udhërrëfyeni i referohemi përgjatë tërë këtij raporti, teksti i plotë i tij mund të gjendet [këtu](#):

Mendimet në hapje

Forumi nisi me fjalët hyrëse nga organizatorët e Forumit:



Biljana Braithwaite
Drejtoreshë e Programit për
Balkanin Perëndimor pranë
Qendrës AIRE



Goran Miletić
Drejtor i Mbrojtësve të të
Drejtave të Njeriut për Evropë

Këto fjalime ofruan një shikim mbi vështirësitë unike të organizimit të një ngjarjeje kaq të madhe dhe komplekse në rrethana kaq të komplikuar. Biljana gjithashtu ua kujtoi pjesëmarrësve që respekti për të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit nuk e pengon mbrojtjen e shëndetit. Përkundrazi, këto forcojnë dhe fuqizojnë njëri-tjetrin në mënyrë të ndërsjellë. Më tej, Goran foli rreth faktit që shkëmbimi i pikëpamjeve dhe përvojave gjatë Forumit i bën jehonë zërit të komuniteteve të margjinalizuara, dhe hedh dritë mbi sfidat urgjente me të cilat përballen ato.


Fjalimi nga Biljana Braithwaite mund të shikohet [këtu](#)



Fjalimi nga Goran Miletic mund të shikohet [këtu](#)



Hartmut Rank, Kryetari i Programit të Sundimit të Ligjit për Evropën Juglindore pranë Konrad Adenauer Stiftung, që është partner kyç i Forumit, përmbylli fjalimet e hyrjes duke na kujtuar që, megjithëse zgjedhja për të shpëtuar sa më shumë jetë që është e mundur ka qenë njerëzore dhe egalitare, të gjithë duhet të jemi të vetëdijshëm dhe të shqetësuar rreth mundësive të autoritarizmit që na kanosen.



2. Rendi i ditës

Rendi i ditës i Forumit

Me titullin “Covid-19 dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut”, Forumi u organizua në katër pjesë substanciale.

1. Presidenti i GjEDNj-së, Robert Spano, dhe Komisionerja e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, Dunja Mijatović, mbajtën fjalime rreth çështjeve që ata i shohin si më thelbësore në lidhje me Covid-19 dhe sundimin e ligjit.
2. Gjyqtarë dhe ish-gjyqtarë të GjEDNj-së diskutuan rreth mënyrave se si të drejtat e garantuara nga KEDNj janë prekur nga pandemia e Covid-19 dhe nga reagimet e Shteteve ndaj pandemisë.
3. Pjesëmarrës të shquar nga qendrat rajonale të Forumit nëpër qytete të ndryshme raportuan pranë selisë qendrore lidhur me rezultatet e diskutimeve në secilën qendër, duke shpjeguar impaktin e Covid-19 dhe reagimit të Shteteve ndaj sëmundjes mbi sundimin e ligjit dhe mbi të drejta të caktuara të KEDNj-së.
4. Gjyqtarë dhe ish-gjyqtarë të GjEDNj-së diskutuan rreth sfidave të ardhshme në mbrojtjen e të drejtave të njeriut nën dritën e jurisprudencës përkatëse të GjEDNj-së dhe në kushtet e Covid-19.

Për informacione dhe hollësi të mëtejshme rreth strukturës së Forumit, shihni Rendin e Ditës 2020 [këtu](#).


3. Fjalimet kryesore

Gjyqtari Robert Spano, President i GjEDNj-së, mbajti të parin prej dy fjalimeve kryesore në Forum.

Presidenti Spano u përqendrua tek rëndësia që ka koncepti i sundimit të ligjit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe për sistemin e Konventës në mënyrë të veçantë, duke theksuar se parimi i sundimit të ligjit është fryma që përshkon Konventën në tërësi dhe qëndron në zemër të themeleve ligjore dhe morale të Gjykatës si dhe parimeve të demokracisë. Gjatë fjalimit gjithashtu u hodh një shikim i përgjithshëm mbi eksperiencën e GjEDNj-së në lidhje me pandeminë e Covid-19, dhe mënyrat se si pandemia ka shërbyer për të vënë theksin mbi sundimin e ligjit për të siguruar që masat e marra nga Shteti me qëllim të parandalimit të përhapjes së virusit të mos shkojnë përtej limiteve jodemokratike dhe që masat e rrepta të emergjencës të mos bëhen normaliteti ynë i ri.



Video e plotë e fjalimit të Presidentit Spano mund të gjendet [këtu](#).



Dunja Mijatović, Komisionerja e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, mbajti fjalimin e dytë prej dy fjalimeve hyrëse në Forum.

Fjala e Komisioneres Mijatović u përqendrua tek viktimat e pandemisë së Covid-19, dhe theksoi që, megjithëse pandemia dhe reagimet e Shteteve ndaj pandemisë kanë vënë kufizime të rrepta mbi të drejtat dhe liritë tona, pandemia më së shumti ka përkeqësuar pabarazitë brenda shoqërive tona.



Fjalimi shtjelloi se si pandemia ka prekur më shumë gratë, pleqtë, refugjatët, romët, komunitetin LGBTQI, personat me paaftësi, dhe pakicat etnike dhe nacionale; pra të gjithë persona që kanë vuajtur nga të njëjtat pabarazi edhe para se të godiste pandemia. Komisionerja Mijatović më tej shtjelloi rëndësinë e luftës kundër disinformatave dhe garantimit të mekanizmave të fuqishme për mbrojtjen e informacionit, rëndësi e cila është shfaqur në mënyrë akute gjatë pandemisë.

Video e plotë e fjalimit kryesor të Komisioneres Mijatović mund të gjendet [këtu](#):



4. Covid-19 dhe Impakti mbi Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut

E drejta për jetën

Fjalimi në lidhje me të drejtën për jetë sipas Nenit 2 të KEDNj-së u mbajt nga Gjyqtari Jovan Ilievski nga Maqedonia e Veriut. Kontributi i tij u përqendrua rreth detyrimit që Konventa u cakton Shteteve për t'u siguruar që e drejta për jetën të respektohet dhe të mbrohet brenda juridiksioneve të tyre, si çështje e rëndësisë madhore në luftën kundër pandemisë Covid-19 në shumë aspekte.

Fjalimi i Gjyqtarit Ilievski mund të gjendet [këtu](#).



Udhërrëfytesi i Forumit

Udhërrëfytesi i Gendrës AIRE për Covid-19 dhe Impaktin mbi të Drejtat e Njeriut i kushton një kapitull të tërë Nenit 2 të KEDNj-së dhe të drejtës për jetën. Udhërrëfytesi parashtron me hollësi mënyrat se si një Shtet mund të veprojë në përputhje me detyrimet e veta rregullatore dhe operacionale për të mbrojtur të drejtën për jetë, dhe mënyrat se si Gjykata mund të gjejë që një Shtet nuk i ka përmbushur detyrat e veta.

Udhërrëfytesi shtjellon thellësisht relevancën dhe rëndësinë e të drejtës për jetën në lidhje me:

- Mbrojtjen e individëve nga kërcënimet ndaj jetës së tyre, siç është pandemia Covid-19.
- Vetlëndimi. Për shkak të frikës, izolimit, distancimit fizik, reduktimit të qasjes në shërbimet mbështetëse, dhe humbjes së të ardhurave, është shënuar rritje e rasteve të vetlëndimit ose mendimeve vetvrasëse gjatë pandemisë.
- Dhuna shtëpiake.
- Jeta e atyre që mbahen në burg nga Shteti, ose atyre që janë nën kujdesin e Shtetit.
- Detyrimi procedural i caktuar mbi Shtetet për të hetuar vdekjet në mënyrë efektive.

Për hollësi të mëtejshme, kapitulli i Udhërrëfytesit mbi të drejtën për jetë mund të gjendet [këtu](#).

Ndalimi i Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor e Degradues

Gjyqtarja Ivana Jeliq, gjyqtare nga Mali i Zi, më tej foli rreth parimeve të Nenit 3 të KEDNj-së, detyrimeve pozitive të Shteteve në lidhje me ndalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor e degradues. Gjyqtarja Jeliq u përqendrua tek zbatimi i Nenit 3 në lidhje me mbrojtjen e të miturve, lirisë dhe shëndetit, dhe përsëriti faktin që Konventa dhe Gjykata ndjekin politikën e tolerancës zero ndaj dështimit të Shteteve për të hetuar shkeljet e Nenit 3.



Fjalimi i Gjyqtares Jeliq mund të gjendet [këtu](#).

Udhërrëfytyesi i Forumit

Udhërrëfytyesi i Qendrës AIRE për Covid-19 dhe Impaktin mbi të Drejtat e Njeriut gjithashtu i kushton një kapitull Nenit 3 të KEDNj-së dhe ndalimit të torturës dhe trajtimit çnjerëzor e degradues. Udhërrëfytyesi shtjellon mënyrat se si detyrimet e Shteteve nga Neni 3 ndërlihen me situatën unike të shkaktuar nga Covid-19, dhe mënyrat se si Gjykata vendos se kur e si një Shtet ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve të veta.

Udhërrëfytyesi parashtron relevancën dhe rëndësinë e ndalimit të torturës dhe trajtimit çnjerëzor e degradues në lidhje me:

- Mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së individëve për të cilët Shteti ka marrë përgjegjësi.
- Reagimet e shëndetësisë publike ndaj sëmundjeve infektive.
- Distancimin social, izolimin mjekësor, dhe mbylljen brenda në vetmi; si për individët e mbajtur në burg nga Shteti, ashtu edhe për popullatën e gjerë.
- Trajtimin e sëmundjeve dhe gjendjeve shëndetësore të tjera përveç Covid-19 gjatë pandemisë.
- Abuzimin shtëpiak.
- Azilkërkuesit dhe migrantët.
- Procedurat e largimit dhe ekstradimit.
- Detyrimin procedural të vendosur mbi Shtetet për të hetuar në mënyrë efektive shkeljet e supozuara të Nenit 3.

Për të eksploruar më tej këtë temë dhe aspektet e renditura më lart, mund t'i referoheni kapitullit përkatës të Udhërrëfytyesit [këtu](#).

E Drejta për Liri dhe Siguri dhe e Drejta për Lirinë e Lëvizjes

Kontribut të rëndësishëm në diskutimet rreth temës së Nenit 5 të KEDNj-së, e drejta për liri dhe siguri, dhe Nenit 2 të Protokollit Nr. 4, liria e lëvizjes, dha ish-gjyqtari i GjEDNj-së për Shqipërinë, Ledi Bianku. Fjalimi i tij kishte të bënte me mënyrën se si Shtetet duhet ta trajtojnë kufirin delikat mes përmbushjes së kushteve për të drejtën e lirisë dhe të drejtën e lirisë së lëvizjes. Duke pasur parasysh që kufizimi i lëvizjes është veprimi më i theksuar që kanë ndërmarrë Shtetet si reagim ndaj pandemisë Covid-19 thuajse në çdo vend, ku të gjithë kemi përjetuar shkurtime pa precedent të lirisë sonë, kontributi i Ledi Biankut në këtë diskutim ishte gurthemel i rëndësishëm në punën e Forumit.

Fjalimi i Ledi Biankut mund të gjendet [këtu](#).



Udhërrëfytyesi i Forumit

Udhërrëfytyesi shoqërues i Qendrës AIRE për këtë Forum përmban dy kapituj që e mbulojnë këtë temë. Njëri kapitull mbulon Nenin 5 të KEDNj-së dhe të drejtën për liri dhe siguri, duke shtjelluar fushëveprimin e Nenit 5, rastet kur mund të lejohen përjashtime prej mbrojtjeve të kësaj të drejte sipas KEDNj-së, dhe garancitë e Nenit 5. Një kapitull i dytë i kushtohet Nenit 2 të Protokollit Nr. 4, e drejta për lirinë e lëvizjes. Ky kapitull është i ndarë në dy pjesë, ku njëra mbulon jurisprudencën e GjEDNj-së mbi lirinë e lëvizjes dhe tjetra praktikën gjyqësore të së njëjtës gjykatë mbi të drejtën për të hyrë në vendin e vet.

Së bashku, dy kapitujt eksplorojnë aspektet e mëposhtme në kontekst të së drejtës për liri dhe siguri dhe të drejtës për lirinë e lëvizjes:

- Dallimi mes kufizimit të lëvizjes dhe privimit të lirisë.
- Pranimi dhe identifikimi i migrantëve, dhe qendrat e regjistrimit.
- Paraburgosja e ligjshme e personave për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse.
- Nevojshmëria e sigurisë ligjore, mungesa e arbitraritetit, arsytimi i duhur, dhe shqyrtimi i shpejtë i paraburgimit paragyqësor sipas Nenit 5.

Kapitulli i Udhërrëfyesit mbi të drejtën për liri mund të gjendet [këtu](#).

Kapitulli i Udhërrëfyesit mbi lirinë e lëvizjes mund të gjendet [këtu](#).

Tejkalimi i Sfidave për Funkzionimin e Duhur të Gjyqësorit

Në lidhje me faktin që funksionimi i duhur i gjyqësorëve në tërë Evropën u sfidua nga pandemia Covid-19 dhe nga reagimet e Shteteve ndaj kësaj sëmundjeje foli Gjyqtari Paul Lemmens i Belgjikës. Kontributi i tij u përqendrua rreth mënyrave në të cilat kufizimet e vendosura mbi shoqërinë si pasojë e reagimit të Shteteve ndaj pandemisë Covid-19 kanë ndikuar tek mundësitë e atyre Shteteve për të vepruar në përputhje me detyrimet e tyre nga Neni 6 i KEDNj-së. Kontributi i tij gjithashtu që i shënuar veçanërisht për prurjen e ideve të reja rreth dixhitalizimit të procedurave gjyqësore dhe përfitimeve afatgjata që ende mund të rezultojnë nga këto sfida të vështira.

Fjalimi i Gjyqtarit Lemmens mund të gjendet [këtu](#).



Udhërrëfyese i Forumit

Udhërrëfyese i Qendrës AIRE për Covid-19 dhe Impaktin mbi të Drejtat e Njeriut i kushton një kapitull të tërë Nenit 6 të KEDNj-së dhe të drejtës për gjyq të drejtë. Udhërrëfyese jep hollësi se si Shteti mund të veprojë në përputhje me detyrimet e veta rregullatore dhe operacionale për të garantuar që procedurat të jenë të drejta, të lehtësojnë pjesëmarrjen efektive në procedura gjyqësore, dhe për të siguruar që individët të gëzojnë të drejtën që kanë për seancë publike brenda një kohe të arsyeshme.

Udhërrëfyesei hulumton relevancën dhe rëndësinë e të drejtës për seancë të drejtë në lidhje me:

- Detyrimet mbizotëruese për të mundësuar drejtësinë e tërësishme dhe pjesëmarrjen efektive, përfshirë garatimin e drejtësisë së seancave që mbahen në distancë.
- Nevojën për të ofruar kushte për seanca publike në kohë pandemie.
- Detyrën për të mbajtur seancë publike brenda një kohe të arsyeshme.
- Detyrimin për të mbrojtur të drejtat e palës mbrojtëse, përfshirë ndihmën ligjore të menjëhershme, praktike dhe efektive, si dhe komunikimet private me avokatin.

Më shumë hollësi lidhur me këto tema mund të gjenden në kapitullin e Udhërrëfyesit mbi të drejtën për seancë të drejtë [këtu](#).

E Drejta për Respektim të Jetës Private dhe Lirisë së Besimit

Gjyqtari Darian Pavli, gjyqtari nga Shqipëria, më tej foli rreth parimeve të Neneve 8 dhe 9 të KEDNj-së, e drejta për respektim të jetës private dhe e drejta për lirinë e besimit. Gjyqtari Pavli u përqendrua në shqyrtimin e aspekteve më komplekse dhe më të diskutueshme të ligjit sipas këtyre Neneve, me fokus tek Neni 8. Ai shtjelloi se si Neni 8 mund të interpretohet si i tillë që garanton disa të drejta të caktuara socioekonomike, për sa i përket mbrojtjes që ofron për aktivitetet profesionale, dhe mënyrën se si kufizimet e organizimit fetar të varrimeve janë tregues që Shtetet duhet të veprojnë në mënyrë proporcionale. Më tej, ai mori në konsideratë zbatueshmërinë e Nenit 8 në lidhje me shqetësimet rreth vëzhgimit dhe mbledhjes së të dhënave nga ana e Shtetit.

Fjalimi i Gjyqtarit Pavli mund të gjendet [këtu](#).



Udhërrëfyeni i Forumit

Udhërrëfyeni i Qendrës AIRE rreth Covid-19 dhe Impaktit mbi të Drejtat e Njeriut po ashtu i kushton një kapitull Nenit 8 të KEDNj-së dhe të drejtës për jetë private. Udhërrëfyeni eksploron mënyrat se si kanë ndryshuar detyrimet e Shteteve sipas Nenit 8 dhe si janë vështirësuar ato nga reagimi i Shteteve ndaj pandemisë, dhe si mund të përmbushen ende këto detyrime.

Udhërrëfyeni parashton relevancën dhe rëndësinë e të drejtës për respektim të jetës private dhe familjare në lidhje me:

- Kujdesin dhe trajtimin shëndetësor.
- Qasjen në informacione lidhur me shëndetin.
- Shëndetin mendor.
- Dhunën shtëpiake.
- Privatësinë dhe mbledhjen e ruajtjen e të dhënave personale.
- Vëzhgimin.
- Mundësinë për të vizituar dhe kaluar kohë me familjarë dhe miq, përfshirë situatat e mbajtjes në burg ose nën kujdes mjekësor nga ana e Shtetit.
- Kufizimet gjatë varrimeve.
- Mënyrat se si Shteti mund të kufizojë të drejtat e garantuara nga Neni 8 pa shkelur Konventën.

Për ta eksploruar më tej këtë temë dhe aspektet e renditura më lart, mund t'i referoheni kapitullit përkatës të Udhërrëfyesit [këtu](#).

Liria e Shprehjes dhe e Tubimit

Në diskutimet rreth temës së Nenit 10 të KEDNj-së, e drejta për lirinë e shprehjes, dhe Neni 11, e drejta për lirinë e tubimit dhe organizimit, kontribut dha gjyqtarja e GjEDNj-së nga Gjermania, Anja Seibert-Fohr. Fjalimi i saj vuri theksin tek nevoja e vazhdueshme për debatin dhe marrëdhënien e lirë mes demokracisë së fuqishme dhe të dy lirive, asaj të shprehjes dhe asaj të tubimit. Gjyqtarja Seibert-Fohr gjithashtu diskutoi rreth nevojës për informacione të sakta dhe të besueshme, rëndësisë së shtypit në kohë krizash, dhe nevojës që gjykatat të shqyrtojnë nëse kufizimet e vëna mbi këto liri janë të tepruara apo proporcionale.

Fjalimi i Gjyqtares Seibert-Fohr mund të gjendet [këtu](#).



Udhërrëfyesi i Forumit

Udhërrëfyesi shoqërues i Qendrës AIRE përmban dy kapituj që e mbulojnë këtë temë. Njëri kapitull mbulon Nenin 10 të KEDNj-së dhe të drejtën e lirisë së shprehjes, dhe tjetri i kushtohet Nenit 11, e drejta për lirinë e tubimit dhe organizimit. I pari kapitull fokusohet në ofrimin e informacioneve të kohshme dhe të sakta, çka është dëshmuar të jetë pjesë thelbësore në luftën kundër pandemisë Covid-19. I dyti kapitull shqyrton se si kufizimet e vëna ndaj individëve për t'u mbledhur në ambiente publike dhe private ndërlidhen me të drejtat që përmban KEDNj-ja.

Së bashku, të dy kapitujt eksplorojnë aspektet e mëposhtme në kontekst të së drejtës për lirinë e shprehjes dhe të drejtës për lirinë e tubimit dhe organizimit:

- Liria e shtypit dhe diversiteti i medias.
- Qasja në informacione.
- Ndërhyrjet tek e drejta për shprehjen e lirë, shkaktuar nga masat e marra si reagim ndaj pandemisë Covid-19.
- Si të përcaktohet nëse kufizimi i të drejtës për shprehjen e lirë është në shkelje të Konventës.
- Detyrimi që Neni 11 vendos mbi Shtetet për të garantuar që çdo kufizim i tubimit dhe organizimit të jetë i parashkruar në ligj dhe të jetë i nevojshëm në një shoqëri demokratike.

Kapitulli i Udhërrëfyesit mbi të drejtën e shprehjes së lirë mund të gjendet [këtu](#).

Kapitulli i Udhërrëfyesit mbi të drejtën për lirinë e tubimit dhe organizimit mund të gjendet [këtu](#).

E Drejta për Arsim, Pasuri dhe Zgjedhje të Lira

Në lidhje me të drejtën për arsim, pasuri dhe zgjedhje të lira foli Mirjana Lazarova Trajkovska, ish-Gjyqtare nga Maqedonia e Veriut. Kontributi i saj u fokusua tek mbrojtjet që përmban Neni 2 i Protokollit Nr. 1, e drejta për arsim, Neni 1 i Protokollit Nr. 1, e drejta për pasuri, Neni 3 i Protokollit Nr. 1, e drejta për votë, si dhe tek mbrojtjet e përgjithshme që parashikohen në lidhje me të gjitha këto çështje nga Neni 8, e drejta për respektim të jetës private. Kontributi i saj u shqua për faktin se përqendrohej tek masat dhe çështjet e lidhura me mbylljen e shkollave dhe mënyrat se si Shtetet mund të reagojnë në rast kolapsi ekonomik.

Fjalimi i Mirjana Lazarova Trajkovska mund të gjendet [këtu](#).



Udhërrëfyesi i Forumit

Udhërrëfyesi i Qendrës AIRE për Covid-19 dhe Impaktin mbi të Drejtat e Njeriut i kushton katër kapituj Nenit 2 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së, Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, Nenit 3 të Protokollit Nr. 1, dhe Nenit 8. Udhërrëfyesi detajon fushëveprimin e secilës prej këtyre të drejtave, atë që mund të përbëjë kufizim të lejuar të secilës të drejtë, dhe mënyrat se si pandemia Covid-19 e ka bërë më jetike mbrojtjen e secilës prej këtyre të drejtave.

Udhërrëfyesi hulumton relevancën dhe rëndësinë e këtyre katër të drejtave në lidhje me:

- Mbrojtjen e shëndetit.
- Mbrojtjen e shprehjes së lirë të vullnetit të njerëzve.
- Të drejtën për të marrë pjesë në fushatë zgjedhore.
- Vështirësitë dhe kushtet për mbajtjen e zgjedhjeve gjatë pandemisë.
- Kushtet për të trajtuar ankesat në lidhje me zgjedhjet.
- Mundësinë e diskriminimit në praktikat arsimore gjatë pandemisë.
- Mbylljen dhe kufizimin e bizneseve gjatë pandemisë.
- Masat, siç janë shtyrjet e qirave, të cilat kanë për qëllim zbutjen e goditjes ekonomike të pandemisë.
- Kompensimin për ndërhyrjen e Shtetit në prona private dhe biznese.

Për më shumë hollësi në lidhje me këto tema, kapitulli përkatës i Udhërrëfyesit mbi të drejtën për votim mund të gjendet [këtu](#).

Kapitulli i Udhërrëfyesit mbi të drejtën për arsim mund të gjendet [këtu](#).


Kapitulli i Udhërrëfyesit mbi të drejtën e pasurisë mund të gjendet [këtu](#).

Kapitulli i Udhërrëfyesit mbi të drejtën për respektim të jetës private mund të gjendet [këtu](#).

Nevoja për Parimet e Ligjshmërisë dhe Proporcionalitetit

Gjyqtari Tim Eicke, gjyqtari nga Mbretëria e Bashkuar, më tej foli rreth parimeve të ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, të cilat janë relevante për të gjitha të drejtat që përmban KEDNJ-ja. Gjyqtari Eicke theksoi që Shtetet prapë se prapë duhet t'i përmbahen ligjit, edhe në kohë krizash dhe emergjencash, dhe që gjykatat më të larta kanë përsipër rolin e mbrojtjes së sundimit të ligjit në kohë të tilla. Ai eksploroj nevojën e vazhdueshme për vlerësimin e proporcionalitetit, sidomos në kohë si këto kur një vlerësim i tillë mund të jetë veçanërisht i vështirë për t'u realizuar.

Fjalimi i Gjyqtarit Eicke mund të gjendet [këtu](#):



Udhërrëfyesi i Forumit

Udhërrëfyesi i Qendrës AIRE për Covid-19 dhe Impaktin mbi të Drejtat e Njeriut gjithashtu i kushton një kapitull parimeve të ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, posaçërisht në kontekst të garancive institucionale dhe procedurale gjatë situatave të krizës. Udhërrëfyesi eksploron se si fuqitë

e emergjencës dhe masat për menaxhimin e krizës mund të jenë në pajtueshmëri me sundimin e ligjit, dhe si disa fuqi të fituara dhe disa masa të caktuara të marra gjatë pandemisë Covid-19 mund të jenë në pajtueshmëri me Konventën.

Udhërrëfyesi paraqet relevancën dhe rëndësinë e ligjshmërisë dhe proporcionalitetit në sistemin e Konventës në lidhje me:

- Procedurën për futjen e gjendjes së jashtëzakonshme ose fuqive të jashtëzakonshme.
- Masat e futura në kuadër të fuqive të jashtëzakonshme.
- Kushtet e përkohshmërisë në lidhje me masat e jashtëzakonshme.
- Zbatimin e masave të jashtëzakonshme.

Më tej, Udhërrëfyesi paraqet rëndësinë e garancive kundër abuzimit në sistemin e Konventës në lidhje me:

- Nevojshmërinë e kontrollit parlamentar mbi degën ekzekutive, përfshirë në lidhje me shqyrtimin *ex post facto* të masave të jashtëzakonshme, dhe impaktin e mbylljeve brenda dhe kushtet e distancimit social mbi funksionimin e duhur të parlamenteve.
- Rëndësinë e kontrollit gjyqësor dhe mbikqyrjes mbi ligjshmërinë e veprimeve të Shtetit, dhe cilësisë së ligjeve të miratuara nga qeveritë gjatë pandemisë.
- Nevojën për mbikqyrje ndër-qeveritare dhe rëndësinë e rolit të ombudspersonit të pavarur në realizimin e llogaridhënies dhe kontrollit.

Për të eksploruar këtë temë dhe aspektet e renditura më lart, mund t'i referoheni kapitullit përkatës të Udhërrëfyesit [këtu](#).

Derogimet nga KEDNj në Kohë Emergjencash

Në diskutimet rreth temës së derogimeve nga Konventa në kohë emergjencash dhe Nenit 15 të KEDNj-së kontriboi gjyqtari i GjEDNj-së nga Bosnja dhe Hercegovina, Faris Vehabović. Fjalimi i tij theksoi rrallësinë e derogimeve, ku deri në kohën e Forumit kishte pasur vetëm dhjetë derogime si reagim ndaj pandemisë. Gjyqtari Vehabović gjithashtu vuri në pyetje nevojshmërinë e derogimit nga Konventa me qëllim të reagimit efektiv ndaj pandemisë, duke shënuar se Shtetet që kanë deroguar dhe ato që nuk kanë deroguar shpesh kanë realizuar saktësisht të njëjtat masa.

Fjalimi i Gjyqtarit Vehabović mund të gjendet [këtu](#).



Udhërrëfyesi shoqëruar i Qendrës AIRE në Forum i kushton një kapitull të tërë derogimeve. Ky kapitull shqyrton se si operon KEDNj-ja në rastet e derogimit, përfshirë kriteret substanciale dhe procedurale që duhen plotësuar në mënyrë që derogimi të jetë në përputhje me Konventën, dhe paraqet argumente në të dy anët e debatit nëse derogimi është i nevojshëm apo i dëshirueshëm për Shtetet në situatën e pandemisë Covid-19.

Kapitulli eksploron aspektet e mëposhtme në kontekst të derogimeve nga KEDNj:

- Whether the Covid-19 pandemic constitutes a public emergency threatening the life of the nation, and so is a suitable justification for derogation,.
- The extent of derogation that may be considered strictly required by the exigencies of the Covid-19 pandemic.
- The consistency of derogations with other obligations under international law.
- Whether derogation is necessary to effectively fight the Covid-19 pandemic.
- How State actions and powers may be scrutinised during a period of derogation.

Kapitulli i Udhërrëfyesit mbi derogimet nga KEDNj mund të gjendet [këtu](#).

5. Raportet nga Qendrat Rajonale në Qytete

Qendra nga Qyteti i Shkupit

Në Shkup, qendra e Forumit pati delegatë nga tërë komuniteti ligjor i vendit të cilët u takuan për të shprehur, diskutuar dhe kontribuar në bisedat dhe debatet mes gjyqtarëve në qendrën bazë.

Në përmbledhje të diskutimeve, Prof. Goran Ilikj dhe Velimir Delovski raportuan që delegatët e Qendrës së Qytetit kishin përjetuar shumë prej sfidave të cekura më lart. Megjithatë, aspekti kyç i përvojës së pandemisë Covid-19 ishte roli i rëndësishëm proaktiv i Gjykatës Kushtetuese në mbikqyrjen e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme nga Qeveria dhe tendencën e saj vijuese për të qeverisur përmes dekretit.

Bisedat e mëtejshme theksuan rëndësinë e reagimit të Qeverisë ndaj pandemisë për sa i përket të drejtës për gjyq të drejtë, dhe përfshinë debatet rreth çështjes nëse Shteti vërtet kishte vepruar në përputhje me detyrimet e veta sipas Neneve 2, 3 dhe 8.

Për hollësi të mëtejshme rreth të gjitha këtyre temave, mund të shikoni raportin e qendrës nga qyteti i Shkupit, i cili mund të gjendet [këtu](#).



Përmbledhjen mund ta lexoni [këtu](#).

Qendra nga Qyteti i Podgoricës

Në Podgoricë, qendra e Forumit në qytet pati delegatë nga tërë komuniteti ligjor i vendit, të cilët u takuan për të shprehur mendime, për të diskutuar dhe kontribuar në bisedat dhe debatet që u zhvilluan mes gjyqtarëve në qendrën bazë.

Në përmbledhje të diskutimeve të kësaj qendre, Gjyqtari i Gjykatës Supreme, Mirash Radović, raportoi që delegatët kishin pësuar shumë prej efekteve fillestare të pandemisë Covid-19, por që kishte pasur një sërë çështjesh të cilat ishin trajtuar nga gjykatat më të larta.



Gjykata Kushtetuese tashmë kishte sjellë gjykime në çështje lidhur me ndërhyrjet në KEDNj, posaçërisht në lidhje me Nenin 8, Nenin 6, Nenin 3, dhe të drejtën për votim.

Gjyqtari Radović theksoi se qasja proaktive e Gjykatës në këqyrjen e kujdesshme të aktiviteteve të Shtetit kishte mbrojtur dhe përforcuar parimet e sundimit të ligjit, dhe solli disa shembuj interesantë të vështirësive me të cilat ishte përballur gjyqësori në përcaktimin e proporcionalitetit të iniciativave kyçe të Shtetit.

Për hollësi të mëtejshme lidhur me këto tema, mund të shikoni raportin e qendrës nga qyteti i Podgoricës [këtu](#):



Përmbledhjen mund ta lexoni [këtu](#).

Qendra nga Qyteti i Prishtinës


Në Prishtinë, qendra e Forumit pati delegatë nga tërë komuniteti ligjor i vendit, të cilët u takuan së bashku për të shprehur mendime, për të diskutuar dhe kontribuar në bisedat dhe debatet që u zhvilluan mes gjyqtarëve në qendrën bazë.

Në përmbledhje të punimeve të kësaj qendre, Flaka Braha raportoi që delegatët në Prishtinë kishin nisur me diskutime rreth vendimit të hershëm të Gjykatës Kushtetuese ku deklarohet që veprimet e Qeverisë ishin pa bazë ligjore. Delegatët gjithashtu diskutuan se si pandemia kishte shkaktuar diskriminime dhe kërcënime edhe më të mëdha ndaj të drejtave të personave në komunitetet e marginalizuara.



Diskutimet dhe debatet e mëtejshme u fokusuan tek nevoja që Shteti të veprojë në mënyrë proporcionale gjatë kufizimit të të drejtave të individëve, posaçërisht në lidhje me të drejtën për kujdes shëndetësor dhe të drejtën për seancë dëgjimore të drejtë.

Për hollësi të mëtejshme rreth këtyre temave, mund të shikoni raportin e qendrës nga qyteti i Prishtinës, i cili mund të gjendet [këtu](#).



Përmbledhjen mund ta lexoni [këtu](#).

Qendra nga Qyteti i Sarajevës


Në Sarajevë, qendra e Forumit pati delegatë nga tërë komuniteti ligjor i vendit, të cilët u takuan për të shprehur mendime, për të diskutuar dhe kontribuar në bisedat dhe debatet që u zhvilluan mes gjyqtarëve në qendrën bazë.

Në përmbledhje të diskutimeve në këtë qendër, Sevima Sali-Terzic, Këshilltare e Lartë Ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese, raportoi që delegatët kishin hasur sfida të shumta në reagimin efektiv dhe proporcional ndaj kërcënimit të Covid-19. Në mënyrë të veçantë, qasja në kujdesin shëndetësor ishte kufizuar për shkak të mbingarkesave në shërbimet shëndetësore ku shumë pacientë, kryesisht ato afatgjatë që nuk vuanin nga Covid-19, nuk mund të merrnin kujdesin që u nevojitej. Gjatë diskutimeve gjithashtu doli që gjykatat në tërë vendin kishin pasur dhe vazhdonin të kishin sfida të konsiderueshme në mbrojtjen e të drejtës për gjyq të drejtë.



Më tej, delegatët diskutuan raste të veçanta ku ishin gjetur shkelje të Konventës në lidhje me Nenin 2 të Protokollit Nr. 4, Nenit 5 dhe Nenit 8. Shqetësim i veçantë për delegatët ishte shpeshtësia dhe pesha e rasteve që kishin të bënin me dhunën shtëpiake.

Për më shumë hollësi lidhur me këto tema, mund të shikoni raportin nga qendra në qytetin e Sarajevës, i cili mund të gjendet [këtu](#).



Përmbledhjen mund ta lexoni [këtu](#).

Qendra nga Qyteti i Tiranës

Në Tiranë, qendra e Forumit në këtë qytet pati delegatë nga tërë komuniteti ligjor i vendit, të cilët u takuan për të shprehur mendime, për të diskutuar dhe kontribuar në bisedat dhe debatet që u zhvilluan mes gjyqtarëve në qendrën bazë.



Në përmbledhje të diskutimeve të kësaj qendre, Dr. Ledina Mandia raportoi që Qeveria kishte bërë derogim nga KEDNj-ja që në fillim të përpjekjeve të saj për të reaguar ndaj pandemisë Covid-19, dhe që më pas kishte pasur probleme me masat e Shtetit për të luftuar përhapjen e sëmundjes të cilat ishin marrë pa konsultime paraprake dhe përmes kanaleve jo të rregullta. Përdorimi i forcës së paligjshme nga forcat e sigurisë gjithashtu kishte përbërë problem në zbatimin e atyre masave për shkak të mungesës së trajnimit dhe mbështetjes për policinë gjatë zbatimit të masave të shëndetësisë publike.

Delegatët gjithashtu diskutuan rreth efekteve negative të pandemisë dhe reagimit të Shtetit mbi të drejtën për arsim, mbi gratë, mbi të drejtën për kujdes shëndetësor, dhe të drejtën për mos-diskriminim. Delegatët njohën faktin që të gjitha masat që kufizonin të drejtat e individëve ishin posaçërisht të tilla në komunitetin rom dhe në grupe të tjera të marginalizuara.

Për hollësi të mëtejshme rreth këtyre temave, mund të shikoni raportin nga qendra në Tiranë, i cili mund të gjendet [këtu](#).



Përmbledhjen mund ta lexoni [këtu](#).

Qendra nga Qyteti i Beogradit

Në Beograd, qendra e Forumit pati delegatë nga tërë komuniteti ligjor i vendit, të cilët u takuan për të shprehur mendime, për të diskutuar dhe kontribuar në bisedat dhe debatet që u zhvilluan mes gjyqtarëve në qendrën bazë.

Në përmbledhje të diskutimeve në këtë qendër, Prof. Marko Milanović dhe Prof. Ivana Krstić raportuan që Shteti kishte deklaruar me shpejtësi gjendjen e jashtëzakonshme për të luftuar përhapjen e pandemisë, por që ishte e paqartë nëse derogimi nga Konventa ishte



i nevojshëm për të marrë masa efektive kundër Covid-19. Delegatët u pajtuan që Shteti duhet ta përmirësojë historikun e komunikimit të pamjaftueshëm në lidhje me rregullat në fuqi, arsyetimin e tyre, dhe dhënien e shpjegimeve përse ishin të nevojshme.

Delegatët gjithashtu njohën natyrën diskriminuese të kufizimeve të Shtetit, sidomos në lidhje me pleqtë, personat me paaftësi dhe romët. Më tej u diskutuan çështje të tjera lidhur me të drejtën për arsim, lirinë e shprehjes, të drejtën për seancë dëgjimore të drejtë, dhunën shtëpiake, dhe trajtimin e refugjatëve dhe azilkërkuesve.

Për hollësi të mëtejshme lidhur me këto tema, mund të shikoni raportin e qendrës nga Beogradi, i cili mund të gjendet [këtu](#).



Përmbledhjen mund ta lexoni [këtu](#).

Qendra nga Qyteti i Zagrebit

Në Zagreb, qendra e Forumit pati delegatë nga tërë komuniteti ligjor i vendit, të cilët u takuan për të shprehur mendime, për të diskutuar dhe kontribuar në bisedat dhe debatet që u zhvilluan mes gjyqtarëve në qendrën bazë.

Në përmbledhje të diskutimeve në këtë qendër, Stefica Staznik, përfaqësuesja para GjEDNj-së, raportoi që Qeveria, ashtu si shumë të tjera në rajon, kishte shpallur gjendjen e jashtëzakonshme në reagim ndaj pandemisë Covid-19 brenda juridiksionit të vet, dhe që Gjykata Kushtetuese kishte kryer me sukses rolin e saj të mbikqyrjes së ekzekutivit dhe fuqive të reja të tij. Një sfidë e veçantë që u vu në pah nga pjesëmarrësit ishte numri në rritje, para të gjitha gjykatave të vendit, i çështjeve në pritje që kanë të bëjnë me akuza që kufizimet e Shtetit kanë shkelur të drejtat e tyre sipas KEDNj-së.

Delegatët gjithashtu diskutuan fushat në të cilat pandemia kishte shkaktuar më shumë kufizime të të drejtave, duke theksuar të drejtën për seancë dëgjimore të drejtë, ndalimin e torturës dhe trajtimin çnjerëzor e degradues, të drejtën për siguri dhe liri, të drejtën për respektim të jetës private, lirinë e shprehjes, lirinë nga diskriminimi dhe lirinë e lëvizjes.



Për hollësi të mëtejshme rreth këtyre temave, mund të shikoni raportin e qendrës nga Zagrebi, të cilin mund ta gjeni [këtu](#).



Përmbledhjen mund ta lexoni [këtu](#).

6. Sfidat e ardhshme

Sfida të Ardhshme për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Sistemit të KEDNj-së

Sesioni i panelit përmblyës të Forumit mori në shqyrtim çështjet dhe sfidat e ngritura nga diskutimet në qendrat nga qytetet e ndryshme si dhe ato të ngritura në bazë, dhe u përpoq të qartësonte sfidat që dalin përpara në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sistemin e KEDNj-së si pasojë e pandemisë Covid-19.

Gjyqtarët Paul Lemmens, Anja Seibert-Fohr, Ivana Jeliq, Darian Pavli dhe Tim Eicke, si dhe ish-gjyqtarët Mirjana Lazarova Trajkovska dhe Ledi Bianku, të gjithë shprehën mendimet e tyre lidhur me çështjen në fjalë.

Debati nga ky sesion i Forumit mund të gjendet në këtë [video](#).



7. Teknologjia dhe Forumi 2020

Në vitin 2020 Forumi u mbështet në teknologji më shumë se asnjëherë më parë. Qendrat nga qytetet e ndryshme ishin në videolidhje të drejtpërdrejtë me qendrën bazë, dhe ishte e rëndësishë jetike që zgjidhja teknologjike karshi problemeve të shkaktuara nga pandemia Covid-19 të ishte funksionale dhe profesionale.

Këtë vit Forumi përdori softuerin KUDO për të transmetuar diskutimet e qendrës bazë online dhe drejt secilës prej qendrave nëpër qytete në format të cilësisë së lartë (high definition). Ky softuer mundësoi përkthim simultan të përsosur në shumë gjuhë, ku anglishtja, boshnjakisht-kroatisht-malazezisht-serbishtja (BCMS), shqipja dhe maqedonishtja ishin në dispozicion për të gjithë pjesëmarrësit online dhe delegatët nga secili qytet.

Pjesëmarrësit online patën mundësinë të marrin pjesë përmes kompjuterëve ose telefonave të tyre pas plotësimit të një formulari regjistrimi, dhe patën mundësinë t'u bënin pyetje pjesëmarrësve të tjerë përmes kutive biseduese të krijuara në platformën KUDO.

8. Vlerësimi i ngjarjes

Gjatë ditëve pas përmbylljes së Forumit 2020, pjesëmarrësit e Forumit nga qendra bazë dhe ato të qyteteve plotësuan një pyetësor të hollësishëm vlerësimi. Një pyetësor i mëtejshëm vlerësimi iu dërgua edhe të gjithë atyre që kishin marrë pjesë përmes platformës sonë online. Kjo na mundësoi vlerësimin e tërësishëm të mendimeve të pjesëmarrësve tanë dhe zhvillimin e mëtejshëm pas përvojës së vetë organizatorëve, në mënyrë që të ofrojmë diçka unike e cila përmirësohet vazhdimisht.


Komentet kthyesë nga pjesëmarrësit e Forumit 2020 ishin shumë inkurajuese, ku arritëm të marrim mendime të vlefshme rreth sukseseve të Forumit dhe aspekteve ku mund të ketë nevojë për përmirësim. Grafikët e mëposhtëm paraqesin një analizë të dobishme të përvojave të pjesëmarrësve.

Si do ta vlerësonit ngjarjen në përgjithësi?

Pjesëmarrësit në qendrën bazë dhe në qytete:




Online attendees:




Si do ta vlerësonit kënaqshmërinë tuaj në lidhje me aspektet e mëposhtme të përvojës gjatë Forumit?

Pjesëmarrësit në qendrën bazë dhe në qytete:



Pjesëmarrësit online:



How would you assess the Forum's focus?

Main and city hub attendees:



Online attendees:



Pas vlerësimit të të dhënave të marra nga pjesëmarrësit e Forumit, organizatorët kanë vendosur të ndërmarrin një sërë hapash pozitivë drejt përmirësimit të përvojës së pjesëmarrësve në vitet e ardhshme:

- Të krijojmë një paketë raportesh nacionale ku të përmbliohen dhe analizohen diskutimet që janë zhvilluar në secilën qendër nëpër qytete, ku të vihet në dukje:
 1. Impakti që ka pasur Covid-19 deri tani mbi secilin juridiksion nacional; dhe
 2. Impakti që me gjasë mund të ketë Covid-19 në të ardhmen, me aq sa kuptohet deri tani.
- Të kuptojmë objektivat e pjesëmarrësve tanë kur marrin pjesë në Forum, dhe të hartojmë ecurinë e ngjarjes në mënyrë të atillë që secili/a të mund të ketë përvojë sa më produktive dhe përmbushëse
- Të plotësojmë dëshirën e pjesëmarrësve tanë që përpara Forumit të shpërndahen informacione të formuluar e të shtjelluara sa më saktë, me qëllim që të mundësohet përgatitje më e fokusuar dhe kontribut më i thelluar në diskutime.
- Të ofrojmë një paketë të përgatitur enkas dhe platformë për shikuesit online, duke iu mundësuar atyre të angazhohen më së afërmi me procedurat mes personave që marrin pjesë në Forum.

9. Fjalët përmbyllëse

Duke qenë në vitin e tij të shtatë, pavarësisht nga sfidat e paraqitura nga pandemia Covid-19, Forumi i Sundimit të Ligjit për Evropën Juglindore vazhdon të shënojë suksese të njëpasnjëshme.

Në fjalimin e tij të mbylljes, Presidenti i GjEDNj-së Robert Spano u shpreh qartë që sundimi i ligjit duhet të kuptohet si bazamenti mbi të cilin ndërtohet struktura e qeverisjes së mirë. Ai po ashtu njohu faktin se Forumi kishte qenë ngjarje transformative, e mundësuar nga shfrytëzimi inovativ i teknologjisë, dhe që suksesi i një ngjarjeje kaq komplekse ishte shenjë pozitive për të gjitha organizatat dhe ngjarjet në këto kohë pandemie.

Fjala përmbyllëse e Presidentit Spano mund të shikohet [këtu](#).



Forum i përfundoi me fjalë përmbyllëse nga Goran Miletij, Drejtor i Mbrojtësve të të Drejtave të Njeriut për Evropë, dhe Biljana Braithwaite, Drejtoreshë e Programit të Ballkanit Perëndimor pranë Qendrës AIRE.

Fjalimet e tyre mund të shikohen [këtu](#).



Informata të mëtejshme rreth Forumit 2020, dhe të gjitha Forumeve të kaluara, në të gjitha gjuhët e rajonit, si dhe regjistrime të të gjitha videove dhe publikimeve, mund të gjenden në faqen e internetit Rule of Law Website <http://rolplatform.org>.

Pikat kryesore të dala nga diskutimet

Nga diskutimet dhe debatet e zhvilluara gjatë dy ditëve të Forumit 2020, mund të nxirren pikat e mëposhtme:

- Pandemia e Covid-19 dhe masat për ta përmbajtur atë ndërhyjnë tek shumë të drejta të KEDNj-së. Nga Qeveritë kërkohet të marrin masa pozitive për të mbrojtur shëndetin dhe jetën e individëve brenda juridiksioneve të tyre, dhe të sigurohen që masat e jashtëzakonshme që ato marrin për të përmbajtur pandeminë të jenë në pajtueshmëri me KEDNj-në.
- Qeveritë duhet të punojnë për të garantuar që masat që marrin në nivel nacional për të luftuar pandeminë e Covid-19 të jenë të ligjshme. Megjithatë, duke pasur parasysh rreptësinë e situatës pandemike, mund të lindë nevoja që kufizimet kushtetuese mbi veprimet e qeverisë të interpretohen nën dritën e situatës unike dhe të vështirë të shkaktuar nga pandemia Covid-19. Arritja e ekuilibrit mes interesit publik dhe të drejtave individuale është kyçe, dhe të drejtat duhet të njihen si të tilla që ekzistojnë në botën reale, pra nuk duhet të shihen vetëm nën prizmin akademik dhe jashtë kontekstit. Sidoqoftë, për të pasur ligjshmëri është e nevojshme që ky ekuilibër të respektojë vetë thelbin e të drejtave të Konventës.
- Kur ekzekutivit i transferohen fuqi të gjera, pavarësisht nëse kjo bëhet përmes shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme apo përmes mënyrave të tjera, bëhet edhe më jetik kontrolli efektiv mbi një pushtet të tillë. Pandemia ka risjellë në vëmendje rëndësinë e këqyrjes parlamentare dhe mbikqyrjen e qeverisë nga gjyqësori dhe avokati i popullit në lidhje me mbrojtjen e sundimit të ligjit dhe respektimin e ndarjes së pushteteve gjatë vendimmarrjes në nivel vendor.
- Shtetet dhe gjyqësori duhet të sigurohen që Gjykatat të funksionojnë në mënyrë efektive, jo vetëm gjatë operimit të përditshëm të sistemit të drejtësisë por edhe në mënyrë që këto gjykata të mund të këqyrin vendimmarrjen qeveritare dhe ligjshmërinë e masave të marra për të luftuar pandeminë Covid-19.
- Gjyqtarët, ushtruesit e profesionit ligjor, akademikët dhe të tjerë në komunitetin ligjor evropian duhet të njohin faktin që pandemia Covid-19 është në shumë mënyra një krizë e llojit të ri për sistemin e Koventës. Prandaj, pyetjet dhe konsideratat që do të dalin dhe zhvillohen nga kriza e tanishme duhet të shqyrtohen në kontekst të jurisprudencës dhe përvojës së kaluar, por duke njohur dhe marrë parasysh njëkohësisht natyrën unike të situatës aktuale, si dhe duke respektuar aspektet origjinale të secilës prej këtyre çështjeve.
- Gjykata në tërë rajonin duhet të jenë proaktive dhe të angazhohen në dialog të hapur me KEDNj-në. Dy pjesët e sistemit duhet të punojnë së bashku dhe të komunikojnë efektivisht në mënyrë që të përcaktojnë përgjigjet për pyetjet e reja ligjore të dala nga pandemia Covid-19. Nuk do të mjaftojë që Gjykatat dhe gjyqësorët nacionalë të punojnë ndaras dhe paralelisht, duke ditur kompleksitetin dhe rëndësinë e detyrës kolektive që kemi përpara vetes.

Hapat e mëtejshëm

Në vazhdimësi të bisedave të zhvilluara gjatë Forumit, Qendra AIRE ka marrë përsipër:

- Të hartojë një seri raportesh nacionale për secilën prej qendrave në qytete, në bashkëpunim me moderatorët e qendrës dhe me ekspertë nacionale dhe rajonale. Këto raporte do të jenë pjesë e diskutimeve nacionale dhe do të analizojnë praktikën gjyqësore të gjykatave nacionale që nga fillimi i pandemisë në kontekst të jurisprudencës së GjEDNJ-së.
- Të përditësojë Udhërrëfyesin e Forumit për Covid-19 dhe KEDNJ-në në vitin 2021, në mënyrë që të merret parasysh situata që ndryshon vazhdimisht dhe zhvillimet në jurisprudencën evropiane në reagim ndaj pandemisë.
- Të punojë për t'u dhënë shtrirje mesazheve dhe tematikave të këtij Forumi drejt vendimmarrësve. Ne do të ndajmë përmbajtjen dhe konkluzionet e diskutimeve tona me vendimmarrësit në rajon, meqenëse jemi të vetëdijshëm për rëndësinë e integritetit të Konventës dhe të drejtës për të drejtat e njeriut në vendimmarrjen e Qeverisë dhe në procesin legjislativ qysh në fillim.

Ju faleminderit të gjithëve për kontributet, dhe ju presim sërish të gjithëve në vitin 2021.